



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:217931
Datë: 31.08.2023
Numri i dokumentit: 04632997

PPP.nr.1/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në lëndën përmbare të kreditorit K.P.M.M kundër debitorit B.Th nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit, për shkak të borxhit, më 28.08.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Propozimi i kreditorit K.P.M.M i ushtruar pranë kësaj gjykate, kundër debitorit B.Th nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit, për shkak të borxhit, **KONSIDEROHET I TËRHEQUR.**

Lënda si e kryer ti deponohet arkivit të gjykatës.

A r s y e t i m

Sipas propozimit të kreditorit K.P.M.M, përmbareuesi privat Gj.R nga Gjakova, ka caktuar përmbareimin sipas Urdhërit P.nr.1196/2019, datë 06.12.2019, në bazë të vendimit përmbareues i dhënë në procedurë administrative - Aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale nr. 5376 të datës 13.10.2011, i formës së prerë të datës 18.11.2011 dhe i ekzekutueshëm me datë 03.12.2011, kundër B.Th nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit, në shumën e përgjithshme prej 11,901.54 euro.

Në bazë të propozimit, gjykata ka caktuar seancën e dëgjimore për datë 28.08.2023, edhe pse kreditori ftesën për seancën e ka pranuar me datë 17.07.2023, ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar, për debitorin ekziston fletëkthesa ku konstatohet se ftesën e ka pranuar personi i tretë, andaj kjo gjykatë duke u mbështetur në dispozitat e nenit 423.3 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke konsideruar se propozimi për përmbareim është tërhequr.

Andaj kjo gjykatë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 423 paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës, vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
PPP.nr.1/2020, datë 28.03.2023

B. Profesional
Armond Qmega

Gj y q t a r i
Betim Behluli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj gjykate për gjykatën e Apelit në Prishtinë – Divizioni Civil.